



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 76, Datë 29.04.2024

MBI

**HEQJEN E PEZULLIMIT TË VENDOSUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.
313, DATË 06.11.2023**

DHE

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SH.P.K. PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SELCA”**

Në mbështetje të neneve 16, 43 dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13, 15 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 163/2 prot., datë 25.04.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.07.2023, shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k. ka paraqitur aplikimin për modifikimin e licencës dhe rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selcë” nga 1,6 MW në 1,98 MW, nëpërmjet zëvendësimit të njërit prej gjeneratorëve ekzistues me një gjenerator më të madh, duke rritur në këtë mënyrë dhe eficiencën e hidrocentralit.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 09.08.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k.

- ERE ka bërë njoftimin në media për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 10.08.2023 dhe 11.08.2023 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data 19.08.2023) nuk ka rezultuar të ketë të tilla.
- Në vijim, me vendimin nr. 269, datë 11.09.2023, bordi i ERE-s vendosi zgjatjen e afatit me 60 (gjashtëdhjetë) ditë, me qëllim që ERE t'i drejtohet me shkresë institucioneve përgjegjëse për marrjen e një miratimi/qëndrimi të mundshëm nga: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) (në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapacitetit të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara); Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) (në rast se nevojitet një VNM Paraprake e re për këtë modifikim); Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) (në rast se leja për përdorimin e burimit ujqor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” me kapacitet të shtuar prej 380 kW).
- Shkresave të ERE-s rezulton se i ka kthyer përgjigje vetëm AKM-ja, e cila me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974/12 prot., datë 23.10.2023, ka informuar se ... *ndryshimi i fuqisë në projekt duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM Paraprake, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.686, datë 29.07.2015.*
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 313, datë 06.11.2023, vendosi të pezullojë vendimmarrjen e tij mbi kërkesën e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri kur të depozitohet në ERE, VNM-ja Paraprake, miratimi/qëndrimi përkatës i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ku të përcaktojë nëse leja ekzistuese vlen dhe për kapacitetin e shtuar prej 380 kW, si dhe qëndrimin/miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 1974/13 prot., datë 07.11.2023, duke i sjellë në vëmendje se duhet të vijojë me procedurat përkatëse për t'u pajisur me VNM-në Paraprake, sikurse përcaktuar në shkresën e AKM-së, e po ashtu të depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor sipas kapacitetit të modifikuar ose qëndrimin e AMBU-së. Po ashtu, për vendimin nr. 313/2023, ERE ka njoftuar dhe MIE-n me shkresën nr. 2437 prot., datë 20.11.2023.
- *Në lidhje me depozitimin e VNM-së Paraprake me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 163/1 prot., datë 05.04.2024, shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k. ka depozituar në ERE Vendim për VNM Paraprake, AN1502202240008, komisioni 42, datë 02.04.2024, për personin juridik “SELCA ENERGJI” sh.p.k., për të zhvilluar projektin “Zëvendësim pajisje elektrike brenda objektit hidroenergjitik, ndryshim gjeneratori për rritje kapaciteti HEC “Selca”, për kapacitetin e shtuar 380 kW.*
- Me depozitimin e këtij dokumenti rezulton se nga shoqëria është plotësuar ky kusht pezullues i vendimit nr. 313/2023, por referuar sa përcaktuar në këtë dokument në lidhje me

vlefshmërinë, vlerësohet që t'i lihet detyrë shoqërisë që të raportojë/dokumentojë në ERE fillimin e punimeve për zëvendësimin e gjeneratorit jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së kësaj VNM-je Paraprake, pra brenda datës 02.04.2026.

- *Në lidhje me qëndrimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, ERE iu drejtua AMBU-së me shkresën me nr. 1974/9 prot., datë 22.09.2023 si organi përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore, për të përcaktuar nëse leja aktuale e shoqërisë vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” me kapacitet të shtuar prej 380 kW. Nuk rezulton që AMBU t'i ketë kthyer përgjigje shkresës së ERE-s. Nga shqyrtimi i VNM-së Paraprake, të depozituar nga shoqëria me shkresën e datës 05.04.2024, rezulton se AKM-ja ka marrë, ndër të tjera dhe mendimin e AMBU-së, e cila në përgjigje ka sqaruar si vijon: *Në përgjigje te kërkeses suaj per VNM paraprake te shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. me zhvillues shoqerine Selca Energji sh.p.k ne lidhje me projektin : Rritja e kapacitetit te HEC SELCA duke zevendesuar gjeneratorin e vjeter me nje gjenerator te ri ne godinen e centralit , me te dhenat me nr Aplikimi AN1522024008 te dates 15.02.2024: Ne rast se do të kemi ndryshime të parametrave hidrike të HEC SELCA, atëherë shoqëria duhet të aplikojë në portalin online të E-albania "Aplikim për përdorim burimi uhor" për t'u pajisur me leje bazuar ne ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020.**
- Referuar sa përcaktuar më sipër, kushti pezullues i vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 313/2023 në lidhje me qëndrimin e AMBU-së rezulton i plotësuar, duke evidentuar detyrimin e shoqërisë për të mos ndryshuar parametrat hidrikë të hidrocentralit.
- *Në lidhje me qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE, me shkresën nr. 1974/3 prot., datë 18.08.2023, i është drejtuar MIE-s, për dijeni “Selca Energji”, duke kërkuar qëndrimin e saj mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave për modifikim licence në ERE, në kuadër të shtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike te privatizuara, për të cilat nuk është në fuqi ndonjë marrëveshje me Autoritetin Kontraktues apo miratim për ndërtim, sipas legjislacionit përkatës për koncesionet apo dhënien e miratimit/autorizimit për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike. Nga MIE nuk ka ende një kthim përgjigje. MIE është njoftuar dhe për vendimin e pezullimit nr. 313/2023 me shkresën e ERE-s nr. 2437 prot., datë 20.11.2023 dhe as pas kësaj shkrese nuk ka pasur asnjë kthim përgjigjeje. Në mungesë të një qëndrimi të MIE-s ku të përcaktohet detyrimi për të marrë miratimin e saj për këto raste, vlerësohet të vijohet me marrjen e vendimi përfundimtar për miratimin e kërkesës së shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e kapacitetit të instaluar të HEC “Selca”, vendimi i cili do të jetë objekt rishikimi në rast të depozitimit të një qëndrimi të ndryshëm nga MIE.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 313, datë 06.11.2023 “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”.
2. Të modifikojë licencën nr. 102, seria PV10P, për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 05.05.2010, modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 07.10.2013.
3. Kapaciteti i instaluar i HEC “Selcë”, nga 1.6 MW bëhet 1.98 MW.
4. Në përmbajtjen e licencës nr. 102, seria PV10P, të pasqyrohen ndryshimet respektive në përputhje me rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selcë”.
5. Shoqëria duhet të raportojë/dokumentojë në ERE fillimin e punimeve për zëvendësimin e gjeneratorit jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së VNM-së Paraprake, brenda datës 02.04.2026.
6. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të depozitimit të raportimit/dokumentit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të një qëndrimi ndryshe nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo organeve/institucioneve të tjera të përfshira në këtë procedurë.
7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SELCA ENERGJI” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRE

Erjola SADUSHI

